



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**RAPORT I MONITORIMIT TË SHIT-BLERJES SË ENERGISË ELEKTRIKE NGA  
GJENERATORI PUBLIK “KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS” (KEK)**

**Nëntor 2022**

## Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	3
Qëllimi i Monitorimit.....	3
Informacion i Përgjithshëm mbi ndërmarrjen nën monitorim .....	3
Trajtimi i energjisë elektrike nga KEK.....	4
Trajtimi i energjisë elektrike sipas Marrëveshjes së Furnizimit me Shumicë (MFSH) në mes KEK dhe KEDS (KESCO) .....	4
Shkëmbimi i energjisë elektrike .....	5
Dhënia dhe marrja e energjisë elektrike KEK - KESH .....	6
Kontratat kornizë në mes KEK dhe palëve tregtare .....	6
Shitja e energjisë elektrike përmes ankandeve të organizuara nga KEK .....	9
Shitja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të veriut.....	14
Shitja e energjisë elektrike për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (FMF) .....	15

## Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në përputhje me Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084), ushtron mbikëqyrje për pajtueshmërinë me kushtet e Licencës, zbatimin e ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Energjinë, zbatimin e akteve, vendimeve dhe udhëzimeve të lëshuara nga ZRRE-ja.

Mbështetur në dispozitat ligjore në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, në zbatim të Monitorimit të Tregut është kryer monitorimi mbi pajtueshmërinë me kushtet e licencës së Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin në vijim KEK), me theks të veçantë monitorimin e procesit të shit-blerjes së energjisë elektrike nga KEK.

## Qëllimi i Monitorimit

Qëllimi i këtij monitorimi është fokusuar në evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, mbi trajtimin e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK, shkëmbimin e energjisë elektrike me KESH, si dhe shit-blerjen e energjisë elektrike nga KEK.

Qëllimi i Monitorimit është dhënia e opinionit të pajtueshmërisë lidhur me tregtimin e energjisë elektrike, nëse në të gjitha aspektet procedurale të KEK janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe kornizën rregullative në fuqi.

## Informacion i Përgjithshëm mbi ndërmarrjen nën monitorim

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK sh.a.) është ndërmarrja kryesore e prodhimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, e cila është korporatizuar në fund të vitit 2005. Asetet e KEK janë nën pronësi të plotë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në periudha të ndryshme kohore, KEK-u kaloi nëpër disa faza të ristrukturimit dhe ndryshimeve organizative e operative. Nga viti 2013 funksioni parësor i KEK është prodhimi i qymyrit dhe gjenerimi i energjisë elektrike. Për të përmbushur këto dy funksione, KEK-u është i organizuar në dy Divizione qenësore, Divizionin e Mihjeve dhe Divizionin e Gjenerimit. KEK operon me mihjen sipërfaqësore të linjitet, gjegjësisht Mihjen e Sibovcit Jugperëndimor, dy termocentrale, TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B".

Rreth 93% të kapaciteteve të instaluar dhe gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë bazohet në dy termocentralet e KEK-ut me linjit: Kosova A (5 blloqe, 2 prej të cilave jashtë operimit) dhe Kosova B (2 blloqe). Kapaciteti i gjithmbarshëm i instaluar i të dy centraleve është 1,478 MW, dhe të njëjtat do të ishin të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën e Kosovës për energji elektrike nëse do të ishin në dispozicion të plotë. Por, për shkak të vjetërsisë dhe mos operimit të dy njësisë të TC Kosova A, kapaciteti operativ neto i gjenerimit i këtyre dy termocentraleve është i zvogëluar dukshëm. KEK aktualisht operon me pesë (5) njësi gjeneruese me kapacitet operativ neto 960 MW.

Aktiviteti i KEK rregullohet me legjislacionin primar dhe sekondar të sektorit të energjisë dhe operon në bazë të licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, e cila është përgjegjëse për

monitorim/mbikëqyrje të zbatimit të kushteve ligjore të licencës. Aktualisht prodhimi i energjisë elektrike nga KEK përfshinë rreth 93 % të energjisë së prodhuar në vend

## Trajtimi i energjisë elektrike nga KEK

KEK, prodhimin e energjisë elektrike e trajton sipas marrëveshjeve të nënshkruara, si Marrëveshja për furnizim me shumicë (MFSH) në mes KEK dhe KEDS dhe Marrëveshjes për shkëmbim/depozitim të energjisë elektrike në mes Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), si dhe tepricat e prodhimit të energjisë elektrike i trajton në treg të lirë në pajtim me “Procedurën për Tregtimin e Energjisë elektrike, të aprovuar nga Rregullatori.

Për periudhën monitoruese është vërejtur se KEK ka ofruar energjinë në dispozicion sipas obligimeve të MFSH-së, pas kësaj ka shkëmbyer një sasi të energjisë elektrike sipas marrëveshjes për shkëmbimin/depozitim të energjisë elektrike, pastaj energjinë elektrike të mbetur në dispozicion, në një periudhë t’i ka ofruar KOSTT për mbulimin e konsumit në veri, dhe tepricat e energjisë elektrike i ka tregtuar në treg të lirë.

Për më tepër, në periudhën shkurt-mars 2022, KEK ka ofruar energjinë elektrike edhe për furnizuesin e mundësisë së fundit (FMF).

Përveç shitjeve të energjisë elektrike, KEK ka realizuar edhe importin e energjisë elektrike, në formë të shkëmbimit me KESH sipas marrëveshjes në mes palëve.

## Trajtimi i energjisë elektrike sipas Marrëveshjes së Furnizimit me Shumicë (MFSH) në mes KEK dhe KEDS (KESCO)

Çmimet e prodhimit për Gjeneratorin publik (KEK SH.A) janë të derregulluara nga data 1 prill 2017. KEK, në bazë të Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë, është i detyruar të ofrojë sasinë e nevojshme të energjisë me prioritet tek furnizuesi (KESCO) për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Pjesën e mbetur të gjenerimit e ofron për OST dhe OSSH për mbulimin e humbjeve me çmime të energjisë të caktuara me marrëveshje në mes të palëve (KEK-OST dhe KEK-OSSH). Tepricat e energjisë elektrike, pas përmbushjes së obligimeve nga MFSH, KEK i ka tregtuar sipas përshkrimit më lartë.

Si rrjedhojë e marrëveshjes për furnizim me shumicë të energjisë elektrike të datës 17 tetor 2012, palët KEK, KEDS, KESCO dhe KOSTT bien në dakord të nënshkruajnë ‘Shtojca’, me afat një vjeçar, qëllimi i të cilëve është t’i bashkëngjiten dhe bëhen pjesë integrale e MFSH-së pa asnjë paragjykim për të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga dispozitat e MFSH-së, dhe të pasqyrojnë çmimet që do t’i paguhen KEK-ut.

Për periudhën 2022-2023, KEK ka përditësuar ‘Shtojcën’ vetëm me KOSTT, derisa me KEDS dhe KESCO janë në proces të nënshkrimit të ‘Shtojcës’.

Në vitin 2021 KEK ka prodhuar energji elektrike rreth 5,770 GWh, derisa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 ka prodhuar 3,446 GWh. Shitjet e energjisë elektrike nga KEK tek KESCO, KOSTT dhe KEDS janë realizuar si në tabelat 1 dhe 2.

*Tabela 1. Shitjet e energjisë elektrike nga KEK, 2021*

2021		Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Energjia ne dispozicion - KEK	Energjia KEK	MWh	540,464	483,059	454,989	508,057	546,535	503,848	424,594	388,706	397,639	519,667	545,198	457,176
	Shkëmbimi me KESH-in -Import	MWh	0	185	550	0	0	0	0	0	0	0	0	6,300
	Energjia ne dispozicion nga KEK	MWh	540,464	483,244	455,539	508,057	546,535	503,848	424,594	388,706	397,639	519,667	545,198	463,476
Alokimi i energjise se KEK	Konsumi i DPQ-së	MWh	9,248	8,936	10,038	10,671	9,729	7,617	8,211	8,300	7,755	9,628	10,552	10,249
	KESCO	MWh	480,812	378,677	371,191	371,427	284,158	272,773	291,600	274,881	294,323	374,022	407,969	415,411
	KEDS	MWh	38,355	68,434	43,865	65,290	60,834	41,273	26,792	21,049	18,589	57,477	68,186	18,822
	KOSTT - TSO	MWh	4,253	6,896	3,838	6,446	6,727	6,097	3,980	4,102	3,657	6,598	7,329	1,977
	KOSTT Veriu	MWh	7,671	10,424	6,547	1,831	15,755	16,815	9,047	8,349	6,051	15,839	8,002	0
	KEK - FMF	MWh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Shkëmbimi me KESH-in -Eksport	MWh	0	706	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Shtijet me kontrata	MWh	11,875	15,082	14,310	59,618	166,525	162,569	80,306	75,346	59,305	56,785	39,220	6,890
	Jobalancet KEK	MWh												
	Total alokimi nga KEK	MWh	552,214	489,155	449,789	515,283	543,728	507,144	419,936	392,027	389,680	520,349	541,258	453,349

Tabela 2. Shitjet e energjisë elektrike nga KEK, 2022

2022		Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
Energjia ne dispozicion - KEK	Energjia KEK	MWh	467,292	491,325	597,238	505,906	468,677	497,756	417,915
	Shkëmbimi me KESH-in -Import	MWh	4,080	0	1,454	19,528	36,528	1,944	5,735
	Total Energjia ne dispozicion nga KEK	MWh	471,372	491,325	598,692	525,434	505,205	499,700	423,650
Alokimi i energjise se KEK	Konsumi i DPQ-së	MWh	11,576	10,001	10,088	8,385	7,693	7,103	7,816
	KESCO	MWh	436,093	410,550	439,009	346,406	283,846	262,194	300,117
	KEDS	MWh	8,407	37,505	86,241	65,621	49,819	47,615	28,003
	KOSTT - TSO	MWh	1,178	5,973	9,141	7,755	6,308	5,917	4,726
	KOSTT Veriu	MWh	1,077	4,588	0	0	0	0	0
	KEK - FMF	MWh	0	404	696	0	0	0	0
	Shkëmbimi me KESH-in -Eksport	MWh	1,718	5,772	13,453	12,945	15,853	67,585	53,946
	Shtijet me kontrata	MWh	1,220	15,321	35,730	79,050	134,843	98,592	18,686
	Jobalancet KEK	MWh							
Total alokimi nga KEK	MWh	461,269	490,115	594,358	520,162	498,362	489,006	413,294	

## Shkëmbimi i energjisë elektrike

Tregtimi i energjisë elektrike, ndër formave të tjera të tregtimit, bëhet edhe në formë të shkëmbimit të energjisë (energji me energji), ku në shumë raste kjo energji konsiderohet si emergjente dhe ka një koeficient të kthimit.

Në vitin 2015, është nënshkruar Marrëveshja për shkëmbim/depozitim të energjisë elektrike në mes Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), e cila është amandamentuar në vitin 2018, dhe ka vlefshmërinë deri në krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë. Kjo marrëveshje përfshinë objektivat, teknikalitetet, koeficientin e depozitimit të energjisë elektrike, situatat emergjente për shkak avarive dhe kushteve hidrologjike, harmonizimi i llogarive të energjisë elektrike të liferuar dhe të pranuar, mbyllja e bilancit vjetor dhe detyrimet e mbetura, zgjidhjen e mos-marrëveshjeve, e tjera.

Parimet bazë dhe teknikalitetet e bashkëpunimit që përcakton kjo marrëveshje janë si në vijim:

- Shkëmbimi/depozitimi i energjisë elektrike për efekt të përmbushjes së detyrimeve për shërbim publik që të dyjat palët ju kanë referuar legjislacioneve përkatëse në fushën e energjisë elektrike;
- Ndihmës së ndërsjellë në rast situatash emergjente, përfshirë këtu rastet e avarive dhe kushtet e vështira hidrologjike që mund të cenojnë sigurinë e dy sistemeve elektroenergjetike;

- c) Shkëmbimi/depozitimi i energjisë elektrike do të kryhet me koeficientin 1:1, ku palët përcaktojnë periudhën e kthimit të energjisë elektrike. Në rastet kur nuk përcaktohet periudha e kthimit, shkëmbimi/depozitimi i energjisë elektrike quhet i lirë, dhe kthimi i saj bëhet pasi palët bien dakort ndërmjet tyre.

## Dhënia dhe marrja e energjisë elektrike KEK - KESH

KEK, pas trajtimit të energjisë elektrike bazuar në MFSH, profilin e mbetur të prodhimit të energjisë elektrike i'a ofron KESH në formë të shkëmbimit, të cilin profil KESH mund të merr si të plotë apo të pjesshëm, varësisht nga nevojat e tyre, për derisa marrja e energjisë elektrike në formë të shkëmbimit nga KESH bëhet pasi palët bien dakord në mes tyre në varësi të nevojës që ka KEK dhe mundësisë për dhënie që ka KESH, përveç rasteve nëse në fillim është përcaktuar në mes palëve periudha e kthimit të energjisë elektrike.

Për të analizuar me detajisht trajtimit e energjisë elektrike të shkëmbyer me KESH, ZRRE ka kërkuar nga KEK, të dhënat për periudhën monitoruese për energjinë në dispozicion (prodhimin nga KEK dhe shkëmbimin me KESH), dhe alokimin e saj në baza mujore, ditore dhe orare.

Gjatë vitit 2021 KEK ka eksportuar energji elektrike në formë të shkëmbimit vetëm në muajin shkurt në vlerë prej 706 MWh, për derisa ka importuar energji elektrike në formë të shkëmbimit në vlerë prej 7,035 MWh. Ndërsa gjatë viti 2022, për periudhën janar – qershor, ka eksportuar energji elektrike në formë të shkëmbimit në vlerë prej 171,272 MWh, për derisa ka importuar energji elektrike në formë të shkëmbimit në vlerë prej 69,269 MWh.

Pas analizimit të të dhënave nga KEK, ZRRE konstaton se, KEK gjatë periudhës monitoruese ka eksportuar vetëm tepëricat e energjisë elektrike në formë të shkëmbimit, ndërsa ka importuar energjinë elektrike në formë të shkëmbimit sipas kërkesave të nevojshme nga KEK, dhe i ka trajtuar sipas MFSH.

### **Të gjeturat dhe konstatimet:**

- 1. KEK ka kërkuar energji nga KESH edhe atëherë kur nuk ka pasur nevojë për FSHU dhe energjinë e pranuar nga KESH e ka ofruar në treg të lirë. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me Nenin 1 të Marrëveshjes për shkëmbim/depozitim të energjisë elektrike në mes Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).**

## Kontratat kornizë në mes KEK dhe palëve tregtare

Parimet bazë për tregtimin e energjisë elektrike në treg konkurrues dhe transparent janë të definuara në Procedurën për Tregtim të Energjisë Elektrike.

Bazuar në këtë procedurë, KEK në dhjetor të vitit 2018 ka hapur tender për parakualifikim për aktivitetin e prokurimit-shitjes së energjisë elektrike, me ç'rast ka nënshkruar kontratë kornizë, me ndërmarjet e paraqitura në tabelën 3.

Tabela 3. Ndërrmarrjet që kanë kontratë kornizë me KEK

Nr.	Emri i Kompanisë Tregtare	Vendi i marrjes së licencës	Statusi*
1	GEN-I Tirana sh.p.k. Dega ne Kosovë	Kosovë	Po
2	Danske Commodities Kosovo sh.p.k.	Kosovë	Po
3	Holding Slovenske Elektrarne d.o.o	Slloveni	Jo
4	MCM Commodities sh.p.k	Kosovë	Po
5	RENRGY Trading Group sh.p.k.	Shqipëri	Po
6	Ener Trade sh.p.k.	Shqipëri	Po
7	Noa Energy Trade sh.p.k.	Shqipëri	Po
8	Noa Energy Trade sh.p.k.- Dega ne Kosovë	Kosovë	Po

\* Statusi nënkupton që kompania ka/s'ka licencë të lëshuar apo të njohura përmes parimit të reciprocitetit nga ZRRE

Bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen **vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë**, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas **parimit të reciprocitetit** këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së.

Për më tepër, sipas:

#### **I. LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË:**

1. Neni 28, par.1 “Aktivitetet e energjisë, kryhen nga ndërmarrjet për energji në bazë të licencave të lëshuara nga Rregullatori.”
2. Neni 28 par.2 “Licencat e lëshuara nga Rregullatori kërkohen për kryerje të aktiviteteve:  
nënp. 10. “furnizimin me energji elektrike, energji termike apo gaz natyror, duke përfshirë transitin, importimin ose eksportimin e energjisë elektrike ose gazit natyror”;  
nënp. 11. “furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike dhe gazit natyror”;
3. Neni 30, par.1 “Licenca lëshohet vetëm për ndërmarrjet e energjisë të regjistruara sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë...”.

#### **II. LIGJI PËR ENERGJINË ELEKTRIKE:**

Neni 32, par.3: “**Licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të njihen në Kosovë.** Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike **pa pasur nevojë për licencë shtesë.** Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale.”

#### **III. RREGULLAT E TREGUT:**

##### **2 Palët dhe Llogaritë**

.....

2.1.2 Para aderimit në Rregullat e Tregut, një Palë duhet të ketë Licencë në përputhje me Ligjin për një ose më shumë Funksione Pjesëmarrëse (që do të aplikohet për atë Palë kur kryen funksionin përkatës, por nuk përjashtohet mundësia që e njëjta Palë mund të kryejë edhe aktivitete tjera sipas ndonjë Funksioni Pjesëmarrës tjetër që ata kanë të drejtë të kryejnë)

2.1.3 Aderimi në Rregullat e Tregut është i obligueshëm për të gjithë të licencuarit, dhe personat juridik të cilët nuk kanë nevojë për licencë, me përjashtim të personave juridik stabilimentet e të cilëve janë të kyçur në Rrjetin e Shpërndarjes, dhe dëshirojnë të kenë Njehsor fizik të regjistruar në një Llogari të Furnizuesit nga ana e AAM

.....

2.1.6 Të gjitha Palët në Rregullat e Tregut duhet të kenë licencë valide ose në mënyrë valide janë të përjashtuar nga nevoja për të pas licencë, përndryshe duhet ta informojnë OT me kohë dhe të iniciojnë proceset e përshkruara në nenin 3.4

.....

#### **IV. PROCEDURA PER TREGTIMIN E ENERGJISE:**

##### **Neni 8 - Kërkesat ligjore dhe administrative**

1. Për çdo tregtim të energjisë elektrike, blerësi/shitësi duhet të kërkojë dokumentet e nevojshme si janë të caktuara në këtë procedurë e të cilat janë të paraqitura në vijim:

.....

- Licencën për tregtim të energjisë elektrike, të lëshuar nga ZRrE për tregtarët që janë themeluar ose regjistruar në Kosovë, ose, nga shtetet përkatëse për tregtarë me energji elektrike që janë themeluar ose regjistruar jashtë Kosovës e që është e njohur nga ZRrE në pajtim me legjislacion në fuqi.

....

Vlen të theksohet se kompanitë tregtare RENRGY Trading Group, Ener Trade dhe Noa Energy Trade kanë licencë të lëshuar nga Rregullatori i Shqipërisë. Kompanitë tregtare Gen-i Tirana, Danske Commodities Kosovo, MCM Commodities, Noa Energy Trade – dega në Kosovë, RENRGY Trading Group dhe Ener Trade kanë licencë nga ZRRE, si dhe licenca e kompanisë Noa Energy Trade për aktivitet të furnizimit njihet në Kosovë sipas parimit të reciprocitetit që nga Maji 2022, ndërsa kompania tregtare Holding Slovenske Elektrane (HSE) nuk është e licencuar në Kosovë dhe nuk ka licencë që i njihet në Kosovë.

ZRRE ka analizuar të gjitha dosjet e palëve që kanë nënshkruar kontratë kornizë me KEK, dhe vlerëson se procesi për parakualifikimin për aktivitetin e prokurimit-shitjes së energjisë elektrike nuk është kryer sipas dispozitave ligjore në fuqi, me ç'rast KEK ka nënshkruar kontrata kornizë me tregtarë të cilët nuk kanë apo i njihet licenca në Kosovë.

Lidhur me këtë, ZRRE ka reaguar disa herë përmes e-mail-it zyrtar si dhe me shkresë zyrtare, ku ka kërkuar nga KEK që të veproj në pajtim me obligimet ligjore të cekura më lartë, dhe të ndaloj aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me ndërrmarje të pa licencuara.

Për më tepër, ZRRE me datë 19.08.2022, ka monitoruar procesin e tregtimit të energjisë elektrike në kohë reale, dhe ka vërejtur se pavarësisht vërejtjeve dhe kërkesave të ZRRE për ndalimin e tregtimit të energjisë elektrike me ndërrmarje të palicencuara, KEK ende kryen aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në mos pajtueshmëri me obligimet ligjore.



### Të gjeturat dhe konstatimet:

1. KEK ka nënshkruar Kontrata Kornizë me ndërmarrjet të cilat nuk janë të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas parimit të reciprocitetit. Bazuar në këtë të gjetur, KEK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

## Shitja e energjisë elektrike përmes ankandeve të organizuara nga KEK

Në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, sidomos gjatë natës kërkesa për energji elektrike është e ulët dhe si rrjedhojë në sistem paraqiten teprica të energjisë të cilat eksportohen.

Pas planifikimit ditor të prodhimit të energjisë elektrike nga KEK dhe kryerjes së obligimeve nga MFSH, nëse shfaqet nevoja për eksport, KEK, sipas Procedurës për Tregtimin e Energjisë, eksporton energji elektrike me çmimet e ofruara përmes ankandeve, me ç'rast duhet të bëjë zgjedhjen e ofertave ekonomikisht më të favorshme.

Tregtimi realizohet përmes adresave elektronike zyrtare (emailave), ku KEK njofton të gjithë tregtarët për shitje të energjisë elektrike me karakteristikat e përcaktuara nga KEK. Njoftimi mund të bëhet një ditë para (day-ahead) ose brenda ditës (intra-day) varësisht kur lind nevoja për eksport.

Për qëllim të monitorimit/analizimit më të detajuar të procesit të tregtimit një ditë para dhe brenda ditës të energjisë elektrike nga KEK, ZRRE ka përzgjedhur si mostër për monitorim, data të caktuara gjatë vitit 2021 dhe 2022, (26 mostra), ku ka kërkuar dokumentacionin e tregtimit të energjisë elektrike, nga procesi i fillimi, hapja e tenderit, deri tek përfundimi i procesit, përzgjedhja e ofertave fituese.

Sa për ilustrim, në vijim është përshkruar procesi i shitjes së energjisë elektrike për dy ankande ditore, bazuar në të dhënat e dërguar nga KEK. Në tabelën 4 është paraqitur sasia e energjisë për shitje nga KEK, ofertat e tregtarëve, dhe ofertat fituese për datën 12.04.2021.

Tabela 4. Tregtimi i energjisë elektrike një ditë para nga KEK, me datë 12.04.2021

Tregtimi një ditë para				
Sasia nga KEK MWh	LOT 1 1,455	LOT 2 700	LOT 3 650	LOT 4
Tregtari	Eur/MWh	Eur/MWh	Eur/MWh	Eur/MWh
ReNRGY			38.49	
ReNRGY			40.14	
HSE	39.11			
EnerTrade		28.00	40.50	
<b>KEK-Fituesi</b>	<b>39.11</b>	<b>28</b>	<b>40.14</b>	

KEK për realizimin e shitjeve të energjisë elektrike për datën 12.04.2021, me datë 11.04.2021, në ora 09:02AM, ka dërguar e-mail të të gjithë tregtarët që kanë të nënshkruar kontratë kornizë. Përmes këtij e-maili tregtarët janë njoftuar se KEK ka nevojë të shes energjinë elektrike për ditën e nesërme, sipas profilit

të ndarë në tre LOT-e: LOT 1 – 1,455MWh, LOT 2 – 700MWh dhe LOT 3 – 650MWh, dhe se afati kohor për pranimin e ofertave është deri në ora 09:10AM.

RNRGY ka dorëzuar ofertën e parë në ora 09:08AM për profilin e plotë të LOT 3, me çmim 38.49€/MWh, me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:25AM.

KEK në ora 9:11AM ka përsëritur procesin e ofertimit duke i'u komunikuar përmes e-mail në të njëjtën mënyrë të gjithë tregtarëve të energjisë elektrike që iu është dërguar ftesa në raundin paraprak, me ç' rast afati kohor për pranimin e ofertave është vazhduar deri në ora 09:20AM.

RNRGY ka dorëzuar ofertën e dytë në ora 09:16AM për profilin e plotë të LOT 3, me çmim 40.14€/MWh, me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:25AM.

Në raundin e dytë të procesit të ofertimit ka marr pjesë edhe HSE e cila ka dorëzuar ofertën e parë në ora 09:19AM për profilin e plotë të LOT 1, me çmim 39.11€/MWh, me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:25AM.

Pas përfundimit të afatit kohor për pranimin e ofertave, departamenti i tregtimit në KEK në ora 9:21AM ka dërguar e-mail menaxhmentit të KEK me renditjen e ofertave dhe vlefshmërinë e tyre, për konfirmimin e ofertave fituese, si më poshtë:

- LOT 1 39.11 €/MWh
- LOT 2 Nuk kemi pranuar ofertë
- LOT 3 40.14 €/MWh

Gjatë pritjes të konfirmimit nga menaxhmenti i KEK, EnerTrade pas përfundimit të afatit kohor për dorëzim të ofertave, ka dorëzuar ofertat e para në ora 09:21AM për profilin e plotë të LOT 2, me çmim 28€/MWh, dhe për profilin e plotë të LOT 3, me çmim 40.50€/MWh.

Menaxhmenti i KEK në ora 9:23AM ka konfirmuar ofertat fituese me çmimet më të larta për LOT 1 dhe LOT 3, përkatësisht kompania HSE për LOT 1, çmim 39.11 €/MWh, kompania RNRGY për LOT 3, me çmim 40.14 €/MWh.

Departamenti i tregtimit në KEK pas pranimit të ofertave të EnerTrade, në ora 9:24AM ka njoftuar menaxhmentin e KEK për këto oferta të cilat janë pranuar pas mbylljes së afatit kohor. Menaxhmenti i KEK, duke e ditur që oferta është pranuar pas mbylljes së afatit kohor të ofertimit, ka konfirmuar ofertën fituese për LOT 2, me arsyetimin se nuk ka pasur oferta të tjera, ndërsa për ofertën për LOT 3, edhe pse ka çmim më të favorshëm, nuk është konfirmuar me arsyetimin se duhet të merret oferta e cila ka ardhur brenda afatit kohor.

KEK ka njoftuar të gjithë tregtarët, përmes e-mailit, për ofertat fituese apo jo fituese të këtij ankandi, dhe ka vazhduar me nënshkrimin e kontratave individuale me palët fituese.

Në vazhdimësi është paraqitur tabela 5 që përfshinë sasinë e energjisë për shitje nga KEK, ofertat e tregtarëve, dhe ofertat fituese për tregtimin një ditë para dhe brenda ditës për datën 07.05.2021.

Tabela 5. Tregtimi i energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës nga KEK, me datë 07.05.2021

Tregtimi një ditë para				
Sasia nga KEK MWh	LOT 1	LOT 2	LOT 3	LOT 4
	2,370	2,610	800	680
Tregtari	Eur/MWh	Eur/MWh	Eur/MWh	Eur/MWh
Danske			64.33	
ReNRGY				22.22
HSE	38.47	40.54	44.85	43.76
ReNRGY				27.54
EnerTrade	39.03	41.22		
<b>KEK-Fituesi</b>	<b>39.03</b>	<b>41.22</b>	<b>64.33</b>	
Tregtimi brenda ditës				
Sasia nga KEK MWh	LOT 1	LOT 2	LOT 3	LOT 4
	680			
Tregtari	Eur/MWh	Eur/MWh	Eur/MWh	Eur/MWh
HSE	60E/97MWh(0-9h)			
Danske	50E/290MWh(0-4h)			
HSE	60.5E/97MWh			
HSE	60.5E/60MWh			
<b>KEK-Fituesi</b>	<b>50(290MWh)+60.5(60MWh)</b>			

KEK për realizimin e shitjeve të energjisë elektrike për datën 07.05.2021, ka organizuar dy ankande, një ditë para dhe brenda ditës me datë 06.05.2021.

#### Ankandi një ditë para

KEK me datë 06.05.2021, në ora 09:01AM, ka dërguar e-mail te të gjithë tregtarët, të cilit janë njoftuar se KEK ka nevojë të shes energjinë elektrike për ditën e nesërme, sipas profilit të ndarë në katër LOT-e: LOT 1 – 2,370MWh, LOT 2 – 2,610MWh, LOT 3 – 800MWh, dhe LOT 4 – 680MWh dhe se afati kohor për pranimin e ofertave është deri në ora 09:10AM.

Danske ka dorëzuar ofertën e parë në ora 09:08AM për profilin e plotë të LOT 3, me çmim 64.33€/MWh, pastaj RNRGY ka dorëzuar ofertën për profilin e plotë për LOT 4, me çmim 22.22€/MWh, dhe me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:25AM.

KEK në ora 9:11AM ka përsëritur procesin e ofertimit duke i'u komunikuar përmes e-mail në të njëjtën mënyrë të gjithë tregtarëve të energjisë elektrike që iu është dërguar ftesa në raundin paraprak, me ç' rast afati kohor për pranimin e ofertave është vazhduar deri në ora 09:20AM.

HSE ka dorëzuar ofertat e para në ora 09:17AM për profilet e plota të LOT-ve, por që është deklaruar që mund të blejmë vetëm një LOT, duke i'a dhënë mundësinë KEK që të zgjidhë LOT-in që është më i përshtatshëm për te, me çmime të ndryshme për LOT-e si më poshtë:

- LOT 1 38.47€/MWh,
- LOT 2 40.54€/MWh,
- LOT 3 44.85€/MWh,

- LOT 4 43.76€/MWh,

me vlefshmëri të ofertave deri në ora 09:25AM.

RNRGY ka dorëzuar ofertën e dytë në ora 09:19AM për profilin e plotë të LOT 4, me çmim 27.54€/MWh, me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:25AM. Pastaj, EnerTrade ka dorëzuar ofertat në ora 09:20AM për profilin e plotë të LOT 1, me çmim 39.30€/MWh, për profilin e plotë të LOT 2, me çmim 41.22€/MWh, me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:25AM.

Pas përfundimit të afatit kohor për pranimin e ofertave, departamenti i tregtimit në KEK në ora 9:21AM ka dërguar e-mail të menaxhmenti i KEK me renditjen e ofertave dhe vlefshmërinë e tyre, për konfirmimin e ofertave fituese, si më poshtë:

- LOT 1 39.30 €/MWh
- LOT 2 41.22 €/MWh
- LOT 3 64.33 €/MWh
- LOT 4 43.76 €/MWh

Menaxhmenti i KEK në ora 9:22AM ka konfirmuar ofertat fituese me çmimet më të larta për LOT-e, përkatësisht kompania EnerTrade për LOT 1 dhe 2 me çmime 39.30 €/MWh, respektivisht 41.22 €/MWh, për LOT 3 kompania Danske me çmim 64.33 €/MWh dhe për LOT 4 kompania HSE me çmim 43.76 €/MWh.

KEK ka njoftuar të gjithë tregtarët, përmes e-mailit, për ofertat fituese apo jo fituese të këtij ankandi. Kompania HSE, edhe pse pas përfundimit të afatave kohore (9:37AM), ka anuluar ofertën për LOT 4, e cila për shkak problemeve teknike nuk ka mundur të sigurojë kapacitete të lira, ndërsa KEK ka pranuar edhe një ofertë të re nga RNRGY në ora 09:34AM, me profil të reduktuar (280MWh), me çmim 37.37 €/MWh, me vlefshmëri të ofertës deri në ora 09:50AM.

Departamenti i tregtimit ka njoftuar menaxhmentin e KEK për anulimin e ofertës nga kompania fituese, HSE, dhe për arritjen e ofertës nga RNRGY. Menaxhmenti i KEK, në mënyrë që ta ruajë parimi i trajtimit të barabart, pjesën e mbetur të energjisë elektrike ka vendosur që të plasohet në programin brenda ditës (Intraday).

KEK ka vazhduar të pranoj oferta nga tregtarët pas mbylljes së afateve kohore, të cilët i ka njoftuar se ankandi është mbyllur për tregtimin një ditë para, por të cilët mund të marrin pjesë në tregtimin brenda ditës.

#### Ankandi brenda ditës

Me datë 06.05.2021, në ora 06:01PM, KEK ka dërguar e-mail të të gjithë tregtarët, të cilit janë njoftuar se KEK ka nevojë të shes energjinë elektrike brenda ditës, sipas profilit LOT 1 – 680 MWh dhe se afati kohor për pranimin e ofertave është deri në ora 06:10PM.

HSE ka dorëzuar ofertën e parë në ora 06:09PM për profil të reduktuar (97MWh), me çmim 60€/MWh, pastaj RNRGY ka dorëzuar ofertën për profilin e plotë për LOT 4, me çmim 22.22€/MWh.

KEK në ora 6:11PM ka përsëritur procesin e ofertimit duke i'u komunikuar përmes e-mail në të njëjtën mënyrë të gjithë tregtarëve të energjisë elektrike që iu është dërguar ftesa në raundin paraprak, me ç' rast afati kohor për pranimin e ofertave është vazhduar deri në ora 16:20PM.

Danske ka dorëzuar ofertën e para në ora 06:12PM për profil të reduktuar (290MWh), me çmim 50€/MWh. Pastaj, HSE ka dorëzuar ofertën në ora 06:17PM për profil të reduktuar, me çmim 60.50€/MWh.

Pas përfundimit të afatit kohor për pranimin e ofertave, departamenti i tregtimit në KEK në ora 6:21PM ka dërguar e-maill menaxhmentit të KEK me renditjen e ofertave, për konfirmimin e ofertave fituese, si më poshtë:

- Oferta 1 - Për 290 MW 50.00 €/MWh në total 14,500.00 €
- Oferta 2 - Për 97 MW 60.50 €/MWh në total 5,869.50 €

Menaxhmenti i KEK në ora 6:25PM ka konfirmuar ofertën fituese me çmim më të ulët për profil të reduktuar (oferta 1), dhe ka urdhëruar që një profil i pjesshëm i energjisë elektrike t'i ofertohej HSE për shitje.

KEK në ora 06.30PM ka ofruar ofertën HSE për profil të pjesshëm (60MWh) ndaj profilit të tij të dorëzuar, me çmim 60.50€/MWh, të cilën HSE, në ora 06:41PM, ka pranuar blerjen e pjesshme të energjisë elektrike, me çmim të dakorduar në mes palëve.

Pas përfundimit të dakordimeve në mes palëve për tregtimin e energjisë elektrike, KEK ka vazhduar me nënshkrimin e kontratave me palët fituese të ankandit.

Në vazhdimësi, ZRRE ka analizuar të gjitha rastet e përzgjedhura dhe vëren se KEK nuk ka procedurë të brendshme të aplikueshme për përzgjedhjen e ofertave fituese, ashtu siç parashihet në Procedurën e Tregtimit të Energjisë Elektrike, andaj në disa raste KEK:

- ka përzgjedhur ofertë fituese, edhe oferta të cilat janë pranuar pasi që është mbyllur periudha kohore e tregtimit;
- ka përzgjedhur oferta fituese, jo sipas çmimit më të favorshëm ekonomikisht, por sipas sasisë së energjisë;
- pavarësisht përzgjedhjes së ofertës fituese të cilat i kanë plotësuar të gjitha kriteret, kontratat individuale KEK i ka nënshkruar me degët e saja nga rajoni të cilat nuk kanë licencë apo nuk i njihet licenca në Kosovë .

#### **Të gjeturat dhe konstatimet:**

1. KEK nuk e ka të aprovuar procedurën e brendshme të bazuar në funksionin e tyre në treg. Bazuar në këtë, tregtimi i energjisë elektrike pa procedurë të brendshme është në kundërshtim me nenin 2, par. 2 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. KEK ka përsëritur procesin e shtijes së energjisë elektrike edhe në raste kur ka pasur oferta Valide. Një veprim i tillë nga KEK është në kundërshtim me nenin 13, par. 1 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
3. KEK gjatë përzgjedhjes së ofertave fituese nuk ka përdorur standard të njëjtë të përzgjedhjes në të gjitha rastet. Bazuar në këtë, përzgjedhja e ofertave fituese nuk është bërë në pajtim me nenin 11 par. 10 dhe nenin 12 par. 1 dhe 3 të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
4. Me nënshkrimin e kontratave individuale me ndërmarrjet, degët e të cilave nuk janë të licencuara në Kosovë, KEK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

## **Shitja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të veriut**

Energjia e furnizuar për katër komunat veriore të Kosovës, prej 02 Dhjetor 2017 e deri më sot, është tërhequr nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) prej rrjetit interkonektiv evropian, duke krijuar një devijim, kostoja e të cilit është ngritur vazhdimisht. Kuvendi i Kosovës përmes rekomandimit të tij të datës 11.05.2021 ka autorizuar KOSTT të mbulojë devijimet e energjisë në katër komunat veriore të vendit: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompenzohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.

Gjatë vitit 2021, përveç në muajin dhjetor, KEK pas kryerjes së obligimeve për FSHU, humbjeve të OST dhe OSSH, tepricat e energjisë elektrike i ka ofruar KOSTT-it për mbulimin e nevojave të 'humbjeve në veri'. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe në vitin 2022, me ç'rast KEK dhe KOSTT vazhdojnë të shfrytëzojnë marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike për humbjet e sistemit, në kuadër të MFSH.

#### **Të gjeturat dhe konstatimet:**

1. KEK i shet energji elektrike KOSTT për mbulimin e humbjeve në Veri të vendit, nën kushtet e marrëveshjes për mbulimin e humbjeve të sistemit. Shitja e energjisë elektrike tek KOSTT për mbulimin e humbjeve në Veri bie në kundërshtim me procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, pasi që në procedurë përcaktohet që tregtimi i energjisë elektrike duhet të i nënshtrohet tregut të lire dhe konkurrues.

## Shitja e energjisë elektrike për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (FMF)

Rregulla për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (FMF) është një nga rregullat që garanton procesin e liberalizmit të tregut në nivelin me pakicë. Bazuar në këtë Rregullë, përzgjedhja e FMF bëhet përmes procesit tenderues, konkurrenca e të cilit është e vlefshme nëse jo më shumë se dy tenderues kanë përmbushur kriteret përkatëse të pranueshmërisë. Në rast të mos arritjes së përzgjedhjes së FMF përmes konkurrencës, atëherë ZRRE përcakton një furnizues që përkohësisht të ushtroj funksionin e FMF, por jo me gjatë se gjashtë muaj, periudhë kjo brenda të cilës duhet të zhvillohet tenderi i ri. Në rast se edhe tenderi i dytë dështon, ZRRE cakton FMF me një akt të veçantë, ku përcakton të gjitha kushtet dhe afatet për vendosjen e obligimit të shërbimit publik në pajtim me këtë rregullë.

Deri më tani, përzgjedhja e Furnizuesit të mundësisë së fundit përmes procesit tenderues nuk është arritur për shkak se nuk është plotësuar kriteri i konkurrencës.

Andaj, duke marrë parasysh dështimin e tenderit për FMF në muajin janar, ZRRE me datë 31 janar 2022, përmes një vendimi ka caktuar KEK që të ushtroj përkohësisht përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për periudhën 31 janar deri 30 korrik 2022. Obligim i është vendosur KEK në kuadër të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike.

FMF është i obliguar që të furnizoj konsumatorët që mbesin pa furnizues në rastet kur furnizuesi i tij ka bankrotuar, licenca e furnizuesit të mëhershëm është revokuar apo ka skaduar, si dhe në rastet kur konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

Konsumatori "NewCo Feronikeli", pasi që i ka plotësuar kushtet për furnizim nga FMF, me datë 11.02.2022 ka nënshkruar Kontratë për Furnizim me Energji Elektrike me KEK furnizuesin, konform obligimeve që i ka FMF-ja. Çmimi i energjisë elektrike për profilin e ngarkesës (base load) deri në 2 MWh/h është caktuar të jetë 70.00 €/MWh, ndërsa për profil të ngarkesës më të lartë se 2MWh/h çmimi i energjisë elektrike do të caktohet në përputhje me nenet 5 dhe 6 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

KEK me qëllim të implementimit sa më të shpejtë të detyrimeve si FMF dhe duke u bazuar në kërkesat e vazhdueshme nga KOSTT për të filluar furnizimin dhe shmangien e jo balanceve të obligimeve që rrjedhin nga kontrata me konsumatorin Feronikelin, me datë 11.02.2022 ka përgatitur dhe nënshkruar Marrëveshje të Brendshme për Furnizim me Energji Elektrike në mes KEK-gjenerimit dhe KEK-Furnizuesit.

Në kuadër të monitorimit ZRRE, me datë 16.02.2022, ka kërkuar nga KEK-gjeneruesi të njoftohet se a janë duke u respektuar obligimet ligjore për tregtimin e energjisë elektrike.

KEK, me datë 25.03.2022, ka njoftuar ZRRE se KEK-Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, shitjen e energjisë elektrike tek konsumatori Feronikeli është duke e realizuar bazuar në marrëveshjen e brendshme për furnizim me energji elektrike në mes KEK-gjenerimit dhe KEK-Furnizuesit.

Pas analizimit të marrëveshjes, ZRRE ka njoftuar KEK-gjenerimin se po e njëjta marrëveshje duhet të ndërpritet menjëherë pasi që nuk është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi, me theks të veçantë, Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike.

KEK-Gjenerimi pas udhëzimit të ZRRE, me datë 30.03.2022, menjëherë ka ndërmarrë masat e nevojshme për të përmirësuar procesin dhe menjëherë ka ndërprerë Marrëveshjen e Brendshme për furnizim me energji elektrike në mes KEK-gjenerimit dhe KEK-furnizuesit.

**Të gjeturat dhe konstatimet:**

- 1. KEK – gjenerimi ka nënshkruar marrëveshje për shitje të energjisë elektrike me KEK – Furnizuesin, duke mos ju nënshtruar kushteve të konkurrencës dhe procedurave të tenderimit. Bazuar në këtë, nënshkrimi i kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike në këtë mënyrë, bie në kundërshtim me nenin 22, par.5 të Ligjit për Energji Elektrike.**